



Pranuar / Dorezuar Prijmeheno/Prodato Received/Delivery	21-04-2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMSTHC	2305/2022		1/3



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.234/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti- kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Jeton Koca- anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti -Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.234/2022 të datës 15.03.2022, të parashtruar nga ankuesi [redacted] me adresë banimi [redacted] kundër organit të punësimit Institucioni i Avokatit të Popullit, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 21.04.2022, në mënyrë unanime mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ, i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.234/2022 të datës 15.03.2022, i parashtruar nga ankuesi [redacted]

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] i punësuar në Institucionin e Avokatit të Popullit sipas plotësim ndryshimit të akt emërimit të datës 29.01.2018, në pozitën "Udhëheqës i divizionit të teknologjisë informative", me datën 31.01.2022 ka parashtruar kërkesën me numër 22/2022 tek Sekretari i Përgjithshëm i Institucionit të Avokatit të Popullit lidhur me kompensimin për shtesat në pagën bazë për IT sipas vendimit me numër 02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Me datën 11.02.2022, Sekretari i Përgjithshëm i Institucionit të Avokatit të Popullit, përmes e-mailit zyrtar e ka njoftuar ankuesin se nuk është kompetent lidhur me kërkesën e parashtruar për kompensimin material për shtesat e IT.

I pakënaqur me njoftimin nga Sekretari i përgjithshëm dhe mos zbatimit të vendimit për shtesat mbi pagën bazë, ankuesi me datën 16.02.2022 ka parashtruar ankesën me numër 47/2022 tek Komisioni për Ankesa i Institucionit të Avokatit të Popullit.

Me datën 14.03.2022 Komisioni i Ankesave i Institucionit të Avokatit të Popullit, ka nxjerrë vendimin me numër 66/2022 me të cilin e ka pezulluar procedurën ankimore të ankuesit deri në zgjidhjen e statusit të ankuesit si punonjës i IAP, pas paraqitjes së dorëheqjes së ankuesit sipas shkresës me numër 59/2022 të datës 01.03.2022 nga ky institucion.

Ankuesi me datën 15.03.2022, ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 1377/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me mos zbatimin e vendimit me numër 07/29 të datës 31.07.2008 si dhe vendimit me numër 02/39 të datës 08.10.2008 të nxjerrë nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 22.03.2022, ka proceduar kërkesën me numër të protokollit 1517/2022 për përgjigje në ankesë tek Institucioni i Avokatit të Popullit, ndërsa me datën 04.04.2022, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga ky institucion së bashku me provat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vendosje meritor ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 1377/2022. të datës 15.03.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin me numër V.nr.01/2022 të datës 14.03.2022 të Komisionit të Ankesave; Kërkesën e ankuesit të datës 31.01.2022 me numër 22/2022; Vendimin me numër Nr.07/29 të datës 31.07.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës; Vendimin me numër Nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës së bashku me aneksin 1 mbi listën dhe titujt e punonjësve që do të jenë përfitues të masave stimuluese duke përfshirë edhe shumën për këto pozita; Sqarimin e datës 04.02.2022 nga Sekretari i Përgjithshëm; Njoftimin e datës 02.04.2022; Njoftimin e datës 11.02.2022; Kërkesën e datës 22.03.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 04.04.2022 nga Institucioni i Avokatit të Popullit me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Dorëheqjen e datës 01.03.2022 nga ankuesi; Vendimin me numër 72/2022 të datës 18.03.2022 për lirimin nga shërbimi civil; Ndryshim plotësimin e ankuesit të datës 29.01.2018; Akt emërimit e ankuesit të datës 01.01.2014 së bashku me përkrahimin e detyrave të punës; Konkursin e datës 14 e 15.10.2013; Kërkesën e ankuesit të datës 07.03.2018 me numër 33/2018; Përgjigjen në kërkesën e datës 04.05.2018; Ankesën e ankuesit të datës 08.06.2018 me numër 108/2018; Sqarimin e datës 06.04.2018 me numër 64/2018; Sqarimin e datës 04.05.2018 me numër 85/2018; Sqarimin e datës 07.03.2018; Vendimin e datës 04.07.2018 me numër 65/2018; Ankesën e ankuesit të datës 31.07.2018; Vendimin me numër A.nr.501/2018 të datës 18.09.2018; Vendimin me numër 99/2018 të datës 04.10.2018; Njoftimin e datës 05.10.2018 me numër 101/2018; Ankesën e ankuesit të datës 16.02.2022; Vendimin me numër A.nr.905/2021; Ankesën e ankuesit të datës 08.06.2018 me numër 108/2018.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës nga palët në këtë procedurë administrative, ka konstatuar se objekti për të cilin ishte nisur procedura administrative në lidhje me këtë ankesë **është bërë i pamundur apo i kotë** andaj edhe mbi këtë bazë ligjore Kolegji merr vendim për **Përfundim të Procedimit Administrativ, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, Konstaton se objekti i shqyrtimit të ankesës se ankuesit është bërë i pamundur ose i kotë, pasi që i njëjti me datën 01.03.2022 ka paraqitur aktin e



dorëheqjes me numër 59/2022 pranë Institucionit të Avokatit të Popullit nga pozita të cilën e ka mbajtur, ndërsa me datën 18.03.2022 Udhëheqësja e Divizionit të Institucionit të Avokatit të Popullit ka nxjerrë vendimin me numër 72/2022 sipas të cilit e ka aprovuar dorëheqjen e ankuesit dhe e ka liruar të njëjtin nga pozita e shërbimit civil , e krejt kjo në pajtim me nenin 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *“Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë”*, andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka vendosur për përfundim të procedimit administrativ në pajtim me nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.234/2022, datë 21.04.2022

Ardita Perçuku-Shyti


Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dorëzohet:

- ❖ Ankuesit
- ❖ Sekretarit të Përgjithshëm të Institucionit të Avokatit të Popullit;
- ❖ Udhëheqësit të Personelit të Institucionit të Avokatit të Popullit dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së.